



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**FAKULTETI JURIDIK**

**FAKULTETI JURIDIK (UP) SHPALL THIRRJE PËR APLIKIM DHE SHPREHJE  
TË INTERESIT PËR ANGAZHIMIN E KATËR (4) STUDENTËVE NË  
PROGRAMET E MËSIMIT KLINIK**

Me qëllim të lidhjes së programeve të Fakultetit Juridik me tregun e punës si dhe zbatimin e aktiviteteve kurrikulare dhe ekstrakurrikulare që kanë të bëjnë me mësimin klinik (klinikat ligjore), Fakulteti Juridik është në proces të funksionalizimit të Qendrës për Studime Klinike e cila do të mbështetet nga partnerët vendor dhe ndërkombëtar. Në kuadër të qendrës do të ketë të angazhuar studentë, të cilët do të ndihmojnë punën dhe koordinimin e aktiviteteve të Qendrës për Studime Klinike.

Klinikat ligjore në kuadër të Qendrës për Studime Klinike të Fakultetit Juridik, do të ofrojnë ndihmë juridike falas “pro bono” për klientët e kualifikuar, të përcaktuar sipas legjislacionit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

### **Detyrat Kryesore**

Ofron ndihmë juridike falas aplikuesve të kualifikuar, në lëmin: civile, administrative, punës, penale, të drejtat e njeriut (dhuna në familje, barazia gjinore, etj), nëpërmjet:

- Këshillave juridike, opinioneve si dhe dokumenteve tjera ligjore për rastet e caktuara;
- Përpilimit të shkresave, parashtresave dhe dokumenteve tjera përcjellëse;
- Kryen hulumtime, analiza lidhur me ofruesit dhe përfituesit e ndihmës juridike falas dhe pas konsultimit me mentorin e rastit: profesorin e fushës dhe/apo profesionistët e praktikës ligjore, prezanton rekomandimet nga të gjeturat hulumtuese;
- Në konsultim me mentorin e fushës, vendosin lidhur me aprovimin apo refuzimin e ndihmës juridike falas;
- Bashkëpunon ngushtë me institucionet relevante, Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas dhe Odën e Avokatëve të Kosovës, lidhur me ofrimin e ndihmës juridike falas;
- Ndërlidhjen me insitucionet e sistemit të drejtësisë, për raste të caktuara që mund të trajtohen apo që janë duke u trajtuar nga Qendra për Studime Klinike;
- Kujdeset për respektimin e të gjitha afateve ligjore në procedimin e shkresave, në pajtim me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës;

- Mban evidencë, ruan dhe arkivon lëndët e përfituesve të ndihmës juridike falas;
- Përpilon raporte të rregullta për mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë, dhe kryen detyra tjera të përcaktuara nga menaxhmenti i Fakultetit Juridik;

### **Kriteret dhe Kualifikimet**

- Të jetë student/e i/e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës (Bachelor ose Master);
- Studentët e studimeve Bachelor duhet të kenë të përfunduar së paku semestrin e V-të, respektivisht vitin e III-të, semestri i I-rë;
- Të ketë notën mesatare, së paku 8.00;
- Të njohë rrjedhshëm gjuhën Angleze (në të folur dhe në të shkruar);
- Të ketë shkathtësi analitike dhe komunikuese;
- Të posedojë shkathtësi bazike të përdorimit të kompjuterit duke përfshirë programet: Word, PowerPoint, Excel, dhe programet tjera softuerike;

### **Dokumentet e kërkuara për aplikim:**

- CV e kandidatit/ës
- Transkripta e notave;
- Letër Motivuese (max. 600 fjalë).

**Kohëzgjatja:** Maksimum deri në një (1) vit.

Të gjitha aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në emailin: **legalclinics@uni-pr.edu** deri me datën **18.09 2022 ne ora 17:00**. Aplikacionet e pranuar pas këtij afati nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.